



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 166, datë 27.7.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,**  
**PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN**  
**E ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË**  
**MJEDISIT, NË KUADËR TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR**  
**ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë, “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, përgjegjës për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të mjedisit.
2. Grupi i punës të kryesohet nga ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - Zëvendësministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
  - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës;


- Zëvendësministrin e Integritit;
  - Zëvendësministrin e Shëndetësisë;
  - Zëvendësministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
  - Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
  - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen, thirren të marrin pjesë:
- titullarët e institucioneve në varësi të ministrive pjesëmarrëse, që do të përfshihen në përgatitjen dhe hartimin e strategjisë së mjedisit;
  - ekspertë të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Integritit;
  - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vepron si koordinator ndërmjet këtij grupi pune dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, si dhe Ministrisë së Financave e Ministrisë së Integritit.
5. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërministror të punës.
6. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me propozimin e grupit ndërministror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtori ose specialistësh të lartë, nga ministrinë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të mjedisit zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive sektoriale

dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrit nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.

8. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës dhe të grupit teknik përcaktohen nga ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
9. Ngarkohet ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**



**SALI BERISHA**